



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 1224 Prot

Gjirokastër më 52 :2024

Lënda:Procesverbal I mbledhjes së dates 31.01.2025

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së dates. 31.01.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot në 31.01.2025 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet te mediateka pranë Universitetit “Eqrem Çabej”. Mbledhja fillon në orën 12:09 Marrin pjesë në mbledhje 19 anëtarë. Mungojnë në mbledhje:Feruni, Aliko, Cacaj, Isaraj, Llogo, Lapa, Eri Shehaj,Peta

Hapet mbledhja nga Znj.Manjola Shehaj.Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Znj. Shehaj paraqet rendin e ditës.

1.Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.12.2024.

2.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-31.01. 2025”.

3.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01-31.01 2025”.

4.P/Vendim “Për miratimin e vendosjes së z. Kujtim Duro në Shtëpinë e të Moshuarve “Shpresa e Jetës”, Gjirokastër.

5. P.Vendim “ Për miratimin e listës së parcelave kullimore verore /dimërore që do të kontraktohen për përdorimin me qira për kullotje për sezonin veror 2025 dhe sezonin dimëror 2026-2026”.

6.P/Vendim “Për miratimin e 2 pozicioneve të propozuara për ndërtimin e Mbrojtjes Ushqimore në Bashkinë Gjirokastër”.

7.P/Vendim“Për miratimin e vend gropsjes së kadavrave të kafshëve të ngordhura në Bashkinë Gjirokastër”.

8. P/Vendim “Për miratimin e Raportit të Vlerësimit të të Ardhura Afatmesme 2026-2028”.

9/P/Vendim “Për disa shtesa në Vendimin nr 86, datë 12.12.2024 “Për miratimin e Programit Afatmesëm 2025-2027 dhe BuxhetitVjetor 2025”

10. P/Vendim “Për një shtesë në Vendimin nr 86, datë 12.12.2024 “Për miratimin e Programit Afatmesëm 2025-2027 dhe BuxhetitVjetor 2025” Përmirësimi i Kapaciteteve të Qendrës Komunitare Sociale “Zinxhira” për të ofruar Shërbime të Specializuara dhe Përfshirëse për Komunitetet e Cënueshme në Gjirokastër”.

11.P/Vendim“Për shprehjen e pëlqimit në parim për realizimin e shpronësimeve në zonën e projektit “Sistemim Asfaltim rruga “Taroninë-Zhulat” Loti 1”

12.P/Vendim “Për shprehjen e pëlqimit në parim për realizimin e shpronësimeve në zbatim të projektit “Rikonstrukcion I rrugës rreth Pallatit të Sportit Gjirokastër”.

13.Për miratimin e bashkëfinancimit dhe listës emërore të familjeve përfutuese në kuadër të aplikimit për përmirësimin e infrastructures me objekt “Rikonstrukcioni I rrugës “Baba Selim, lagjja “Zinxhira” Gjirokastër”.

8.Të ndryshme.

Znj Shehaj lexon dhe pareqet para këshillit 2 pika shtesë të propozuar nga egzekutivi.

P/V“Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme(sot ASHK) për lidhjen e kontratave para noterit”, për z. Nesti Çorti.

P/V “Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme(sot ASHK) për lidhjen e kontratave para noterit”, për z. Luan Seiti”.

Miratohet me 20 vota pro rendi I ditës së mbledhjes me dy pikat shtesë.

Hidhet në vote dhe miratohet me 20 vota pro procesverbalit i mbledhjes së dates 27.12.2024

Znj. Shehaj paraqet pikat 2 dhe 3 të rendit të ditës .

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-31.12.2025.

3.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01-31.01.2025”, të cilat miratohen me 21 vota pro.

Znj. Shehaj Kalohet te pika 4 e rendit të ditës e cila ka kaluar në Komisionin e Shendetësisë, Barazisë Gjinore dhe Ceshtjeve Sociale ,ku është kërkuar informacion për arsyet e largimit të z. Kujtim Duro nga Shtëpia e të Moshuarve.

Z. Arianit Muho: Komisioni është mbledhur dhe ka votuar për t ia sjellë këshillit duke kërkuar procesverbal për arsyet e largimit. Procesverbalit na erdhi, por nuk është firma e personit.

A është dakord personeli pasi e kanë larguar që ai të rikthehet prapë, sepse kam informacion që ka patur problem me sjelljet e tij.

Z. Petrit Brahim; Mbështes parafolësin me të gjitha arsyet që tha.

ZNJ. Dorina Demo, Drejtoresha e Shtëpisë së të moshuarve informon se në muajin maj 2024 nga Shërbimi Social Shtetëror është akomoduar pranë nesh deri në 29 qershor.Pak ditë pasi erdhi në institucion z.Duro filloi me veset e tij dhe sjelljet e pahijshme. Një javë para se të largohej përfundimisht hynte dhe dilte nga institucioni. Kam bërë edhe denoncim, por është madhor në vendimet dhe sjelljen e tij.

Nëse ju e votoni do ti bëj direct shkresë SHSSH për transferimin e tij.

Z. Adrian Novi: po flasim për jetën e një njeriu dhe për të drejtat e tij dhe nuk na takon të heqim përgjegjësinë nga vetja. Sipas jush ky zotëri nuk mund të futet aty, po cila është zgjidhja? S' mund ta lëmë në rrugë. Zgjidhja duhet të jetë institucionale.

ZNJ. Demo unë e kam marrë konfirmimin për transferim. Nuk lihet në rrugë.

Vjen në mbledhje znj. Sufati.

Znj. Manxhari: Ne e kemi detyrim institucional për të trajtuar cdo qytetar në raste të tilla, dhe kur institucioni ka vende të lira ne përgatisim dokumentacionin. Orientimi seksual është individual.

Z. Brahim: Të dërgohet në qendra të tjera të specializuara.

ZNJ. Rova: Të shikohet mundësia për ta shoqëruar në qendra të specializuara për këta persona sepse njësoj do veprojnë si herën e kaluar. Drejtorja ka detyrim ta paraqesë në këshill. Por duhen saktësuar për këta persona.

Z. Drasa: Mund të shtyhet dhe të plotësohet me një realacion tjetër

Hidhet në votë dhe rrëzohet p/vendimi "Për miratimin e vendosjes së z. Kujtim Duro në Shtëpinë e të Moshuarve "Shpresa e Jetës", Gjirokastër me 19 vota kundër dhe një abstenim.

Kalohet te pika 5 e rendit të ditës.

Z. Brahim: është rutinë , të jemi të lumtur që kemi kërkesa për dhënien e kullotave. Drejtorja ua ka plotësuar kushtet dhe nuk ka ankesa.

Hidhet në votë dhe miratohet me 20 vota pro "Për miratimin e listës së parcelave kullimore verore /dimërore që do të kontraktohen për përdorimin me qira për kullotje për sezonin veror 2025 dhe sezonin dimëror 2025-2026".

Kalohet te pika 6 e rendit të ditës;

"Për miratimin e 2 pozicioneve të propozuara për ndërtimin e Mbrojtjes Ushqimore në Bashkinë Gjirokastër".

Sqaron nga ekzekutivi znj. Lelaj: Jemi në fazën fillestare të këtij procesi në studimin e fizibilitetit dhe konservimit për dy vite. Do të jetë në dispozicion të fermerëve, por theksoj që jemi në fazën fillestare të këtij projekti. Do të funksionojë si një treg bujqësor dhe blektoral si pikë shumice. është një projekt që financohet nga Banka Botërore dhe Ministria e Bujqësisë.

Z. Drasa: Pse të mos presim të jenë fondet gati dhe projekti?

Znj. Rova: Është faza e parë , duhet miratuar kjo fazë dhe vjen përsëri në këshill.

Hidhet në votë dhe miratohet me 20 vota pro P/Vendimi "Për miratimin e 2 pozicioneve të propozuara për ndërtimin e Mbrojtjes Ushqimore në Bashkinë Gjirokastër".

Kalohet në pikën 7 të rendit të ditës. P/Vendim "Për miratimin e vendit grupor të kafshëve të ngordhura në Bashkinë Gjirokastër".

Z. Petrit Brahim: Nismë e vonuar se është problem për kafshët e ngordhura.

Z. Drasa: A I përmbushin standardet pikat e gjetura?

Znj. Amarilda Lelaj: Po janë jashtë qendrave të banuara dhe larg burimeve ujore dhe nga ana gjeologjike

Miratohet me 20 vota pro P/Vendim "Për miratimin e vendit grupor të kafshëve të ngordhura në Bashkinë Gjirokastër".

Në lidhje me P/Vendim "Për miratimin e Raportit të Vlerësimit të të Ardhura Afatmesme 2026-2028z. Brahim kërkon që herë tjetër të ketë një lëclacion të përmbledhur me pika, sepse ka shumë të dhëna që nuk kuptohen plotësisht.

Hidhet në votë dhe miratohet me 20 vota pro P/Vendim "Për miratimin e Raportit të Vlerësimit të të Ardhura Afatmesme 2026-2028".

P/Vendim "Për disa shtesa në Vendimin nr 86, datë 12.12.2024 "Për miratimin e Programit Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit Vjetor 2025" hidhet në votë dhe miratohet me 20 vota.

Hidhet në diskutim P/Vendim “Për një shtesë në Vendimin nr 86, datë 12.12.2024 “Për miratimin e Programit Afatmesëm 2025-2027 dhe BuxhetitVjetor 2025” Përmirësimi I Kapaciteteve të Qendrës Komunitare Sociale “Zinxhira” për të ofruar Shërbime të Specializuara dhe Përfshirëse për Komunitetet e Cënueshme në Gjirokastrë”.

Sqaron znj. Koko” Ky është një project I filluar dhe mbaron në mars 2026, kurse projekti I ri është në lidhje me UNICEF-in ku 70.000euro financim nga UNICEF dhe 20.000 euro nga bashkia, I cili fillon në 1 shkurt 2025 dhe mbaron në 31 mars 2026.

Hidhet në votë dhe miratohet me 20 vota Vendim “Për një shtesë në Vendimin nr 86, datë 12.12.2024 “Për miratimin e Programit Afatmesëm 2025-2027 dhe BuxhetitVjetor 2025” Përmirësimi I Kapaciteteve të Qendrës Komunitare Sociale “Zinxhira” për të ofruar Shërbime të Specializuara dhe Përfshirëse për Komunitetet e Cënueshme në Gjirokastrë.

Kalohet te pika 11 P/Vendim“Për shprehjen e pëlqimit në parim për realizimin e shpronësimeve në zonën e projektit “Sistemim Asfaltim rruga “Taroninë-Zhulat” Loti 1”

Z.Brahimi: Kam rezerva në lidhje me rrugën, pse janë keto zig-zage te rruga?Gjithashtu pse vijnë tani shpronësimet, unë kam informacion se rruga ka filluar.Pse zgjatet me kthesa? Ose të ndiqet rruga e vjetër.

ZNJ. Amarilda Lelaj: Gjurma e rrugës në project ka pësuar ndryshime, por jemi në fazën që do ketë përshtatje gjatë ndërtimit.

L. Rova : Aka ndonjë problem për ndryshimet që mund të bëhen më pas në zbatimin e projektit për ndërtimin e rrugës?

Z. Guçe: Si këshilltar e njoh zonën dhe kam biseduar edhe me banorët dhe e njoh gjendjen. Rruga kap dhe Taroninë dhe Zhulatin, është fshat Taronina me 15 familje.Nuk ka ankesa për zbatimin e projektit.

Hidhet në votë dhe miratohet me 20 vota pro; P/Vendim“Për shprehjen e pëlqimit në parim për realizimin e shpronësimeve në zonën e projektit “Sistemim Asfaltim rruga “Taroninë-Zhulat” Loti 1”

Kalohet te pika 12 e rendit të ditës.P/Vendim “Për shprehjen e pëlqimit në parim për realizimin e shpronësimeve në zbatim të projektit “Rikonstruksion I rrugës rreth Pallatit të Sportit Gjirokastrë”

Z. Drasa: Përse bëhet fjalë te Pallati I Sportit? Anuk është shtet hapësira rreth tij për të bërë shpronësimet?

Z. Brahimi: Ku ka tokë aty dhe kujt do t i merret kjo tokë?

Znj. Lelaj: Toka përballë supermarketit është private, do bëhen shpronësimet për të vazhduar me punimet e duhura dhe më pas kalon në pronësi të bashkisë dhe I jepet me qira subjekteve ppër parkim.

Z. Drasa: Nuk investohet mbi tokë shtet, aty ka qene shtet.

Z. Qeli: Duhet parë letrat se kot nuk e sjellin këtu.

ZNJ. Lelaj: Ne kemi marrë përgjigje nga ASHK-ja për statusin e sipërfaqes ku do investohet.

ZNJ. Koko: Është e nevojshme të bhet shpronësimi për të vazhduar investimi. Ne marrim statusin actual të pronës para investimit.

Hidhet ne votë dhe miratohetme 20 vota pro:

P/Vendim "Për shprehjen e pëlqimit në parim për realizimin e shpronësimeve në zbatim të projektit "Rikonstruksion I rrugës rreth Pallatit të Sportit Gjirokastër".

Kalohet te pika 13

P/V "Për miratimin e bashkëfinancimit dhe listës emërore të familjeve përfituese në kuadër të aplikimit për përmirësimin e infrastructures me objekt "Rikonstruksioni I rrugës "Baba Selim", lagjja "Zinxhira" Gjirokastër".

Znj. Lelaj : jemi në fazë e parë. Kemi bërë projektin dhe jemi në fazën e aplikimit.

Hidhet në votë dhe miratohet me 20 vota pro P/V "Për miratimin e bashkëfinancimit dhe listës emërore të familjeve përfituese në kuadër të aplikimit për përmirësimin e infrastructures me objekt "Rikonstruksioni I rrugës "Baba Selim, lagjja "Zinxhira" Gjirokastër"

Diskutohet kërkesa e familjes Kano për ndërtimin e një rampe te ppallati tyre.

Parimisht këshilli ra dakord që kjo gjë të delegohet te ekzekutivi dhe të shikohet mundësia për të ndërhyrë Brenda kuadrit ligjor.

ZNJ. Lelaj: Ne e kemi parë situatën dhe kërkesën por nga ana teknike nuk mund të ndërtohet për shkak të raportit të hapësirës e cila duhet 1/12.

Gjithashtu u kërkua ndihmë financiare për këtë familje.

Mbyllet mbledhja nga znj. Shehaj në orën 13.08

Sekretar I këshillit

Etleva Yzo

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita ISARAJ